

TLAS




SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 1 2010



Botimi i këtij materiali është mbështetur
financiarisht nga UNICEF

unicef

TLAS në trainimin e administratës publike ne projektin e financiar nga UNICEF

Një nga objektivat e punës dhe aktiviteteve të TLAS është trainimi i punonjësve të administratës publike në lidhje me tema dhe çështje konkrete që ndikojnë në aksesin në drejtësi dhe në të drejtat sociale të grupeve vulnerabël.

Këto trainime dhe tryeza do të përgatisin dhe ndërgjegjësojnë më mirë punonjësit e administratës publike në ofrimin e shërbimeve të tyre ndaj grupeve dhe individëve vulnerabël, që janë edhe grupet e synuara nga TLAS.

Vitet e fundit, pjesa kryesore e aktiviteteve të ofrimit të shërbimeve ligjore falas për njerëzit në nevojë ka patur si objektiv të saj regjistrimet civile (regjistrimet e lindjeve, vdekjeve, procedurat e transferimit të vendbanimit, etj). Për rrjedhojë, u gjykua që duhej bërë një punë e madhe

trainuese dhe përgatitore me nënpunësi e zyrave të gjendjeve civile në të gjithë Shqipërinë, në mënyrë që ata të përgatiteshin më mirë dhe të ishin më të gatshëm në ofrimin e shërbimeve të tyre ndaj grupeve dhe individëve vulnerabël.

Kjo ishte më e domosdoshme edhe në kushtet kur po bëhej informatizimi dhe dixhitalizimi i regjistrit të gjendjes civile dhe ku, tashmë, të dhënat do të pasqyroheshin në mënyrë elektronike. Duke vlerësuar edhe nivelin e përgatitjes teknike dhe juridike të shumë prej punonjësve të zyrave të gjendjes civile, veçanërisht në rrethet e largëta nga Tirana, trainimi i nëpunësve të gjendjes civile u kthye në një domosdoshmëri praktike.



Mënyra sesi stafi i gjendjes civile i përgjigjet nevojave të publikut ka një ndikim të rëndësishëm në administrimin e legjislacionit për gjendjen civile dhe çështje të tjera të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rastet e qytetarëve. Stafi që pret individët, është i vetmi kontakt që publiku ka organet e pushtetit vendor, dhe që në atë moment krijojnë perceptimin e tyre për funksionimin e shtetit dhe të sistemit të shërbimeve. Mënyra sesi ky staf i përgjigjet nevojave të individëve mund të ndikojë drejtpërdrejt edhe në aksesin që këta individë do të kenë në shërbimet shoqërore, arsimore, shëndetësore, gjyqësore, etj.



Pra, pa dyshim, stafi i zyrave të gjendjes civile ka një përgjegjësi të madhe që ndikon në zbatimin e legjislacionit të gjendjes civile. Ata mund të bëjnë shumë që zyrat e gjendjeve civile të jenë të aksesueshme dhe të hapura për publikun, duke i shërbyer atyre sa më mirë dhe duke rritur edhe besimin e publikut tek sistemi. Prandaj, ishte e rëndësishme që të gjithë punonjësit e zyrave të gjendjes civile në të gjithë Shqipërinë të trainoheshin për mënyrën sesi dhe çfarë informacioni do t'i jepnin publikut, se çfarë do të konsiderohej informacion ose këshillim që duhej dhënë dhe se si do të ishte mënyra etike e dhënies së këtij informacioni.

Trainimet do të synonin në krijimin e standardeve të përbashkëta për të gjithë punonjësit e zyrave të gjendjes civile në të gjithë Shqipërinë:

Së pari, çfarë informacioni mund të konsiderohej si etik dhe çfarë udhëzimesh mund të japin ata për të shmangur re-

fuzimet e panevojshme, mungesën e informimit dhe sqarimin e qytetarëve.

Së dyti, ishte i nevojshëm unifikimi i standardeve në të gjithë vendin. Standartizimi ishte i nevojshëm, në mënyrë që përkufizimet të ishin të njëjta në të gjitha zyrat e gjendjes civile në të gjithë Shqipërinë. Zyra të ndryshme kishin praktika të ndryshme për informacionin që mund të jepte stafi. Në kuptimin e aksesit të qytetarëve, kjo mund të thotë që ata në zyra të ndryshme, mund të mos merinin të njëjtin informacion e për rrjedhojë mund të mos kishin të njëjtat mundësi aksesit për të përfituar nga shërbimet e tjera ligjore ose shoqërore.

Së treti, i gjithë informacioni që ishte i disponueshëm mund të mos ishte në një format që mund të përdorej lehtësisht. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile kishin nevojë për mjete dhe referenca pune të lehta, në mënyrë që ata të vepronon në mënyrë etike, eficiente dhe komunikuese në

ofrimin e shërbimeve.

Së fundi, në kuadrin e informatizimit dhe përsosjes së sistemit të mbajtjes së të dhënave të gjendjes civile, punonjësit e zyrave të gjendjes civile që ishin mësuar me mënyrat tradicionale të mbajtjes së dokumentacionit në letër, kishin nevojë për trainime të shpejta që t'i përshtateshin sistemit të ri të mbajtjes së të dhënave të gjendjes civile.

TLAS hartoi dhe nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme (në varësi të të cilës është gjendja civile) për zbatimin e projekteve të trainimit.



Më pas u hartua projekt-propozimi, i cili iu paraqit UNICEF dhe ky i fundit e financoi projektin për trainimin e zyrave të gjendjes civile në dy grante të veçanta.

Gjatë vitit 2009 dhe Janarit të 2010, TLAS ka realizuar 16 seminare e trainimi me punonjësit e zyrave të gjendjes civile për njohjen dhe interpretimin e ligjit të gjendjes civile në kushtet e kuptimit të ndryshimeve në ligj, të informatizimit dhe hartimit të regjistrit kombëtar, në kushtet e fuqizimit të Komuniteteve Vulnerabël për rritjen e aksesit në shërbimet.


Trainimet janë zhvilluar si më poshtë:

- Fier, dy seminare trainuese në datat 28 dhe 29 Janar 2009;
- Durrës, dy seminare trainuese në datat 5 dhe 6 Shkurt 2009;
- Tiranë, tre seminare trainuese në datat 11, 12 dhe 13 Shkurt 2009;
- Shkoder, një seminar trainues në datën 18 Dhjetor 2009;
- Lezhe, një seminar trainues në datën 23 Dhjetor 2009;
- Berat, një seminar trainues në datën 26 Dhjetor 2009;



- Pukë dhe Malësia e Madhe, një seminar trainues në datën 27 Dhjetor 2009;
- Vlorë një seminar trainues në datën 30 Dhjetor 2009;
- Gjirokastrë një seminar trainues në datën 8 Janar 2010;
- Sarandë një seminar trainues në datën 9 Janar 2010;
- Pogradec një seminar trainues në datën 22 Janar 2010;
- Korçë një seminar trainues në datën 23 Janar 2010;

Për pjesëmarrjen në këto trainim, shihni grafikun e mëposhtëm:



Në total janë trainuar në të gjitha rrethet e përshkruara më lart në të gjithë Shqipërinë 388 punonjës të zyrave të gjendjes civile.

Trainimet kanë qenë mjaft të suksesshme dhe do të vazhdojnë edhe në vitin 2010 në rrethe të tjera të Shqipërisë.

Elton Lula
Drejtues Projekti i TLAS

Rekomandimet e Studimit të Legjislacionit të ndihmës dhe Shërbimeve Shoqërore

Ne perfundim të vëzhgimeve të studimit për vlerësimin e legjislacionit për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, paraqesim rekomandimet e mëposhtme:

Ndihma Ekonomike (NE)

1. Duhet të thjeshtohet dokumentacioni që paraqitet nga kryefamiljari për perfitimin e NE.



Mendoj se dokumentacioni që paraqitet nga kryefamiljari duhet të provojë gjendjen familjare të tij, të ardhurat apo perfitimet që ata marrin si PAK apo pensioniste (nese ka të tilla si anetare familje). Dokumentacioni tjetër duhet të kërkohej zyrtarisht nga struktura e ndihmes dhe perkudjes shoqërore në njësinë e qeverisjes vendore në zyrat e tjera të administratës shtetërore prane të cilave administrohet informacioni i kërkuar. Një proces i tillë ka filluar për një pjesë të dokumentacionit, por duhet të vazhdojë edhe për pjesën tjetër (si p.sh në rastet e ndryshimit të vendbanimit, apo kur familja jeton në njësi qeverisje vendore të ndryshme nga njësia ku ka në pronësi token etj).

Rregullimi lidhur me këtë çështje duhet të bëhet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe masës së ndihmes ekonomike” (i ndryshuar).

Nga praktika e punës së organizatave që punojnë me këtë target grup apo nga eksperien-

ca e grumbulluar nga strukturat shtetërore të ndihmes sociale rezulton se, jo rrallë ndodh që persona realisht në nevojë dhe në kushte tejet të varfëra nuk përfitojnë nga sistemi i ndihmes. Me konkretisht, grupe të personave me nivel shumë të ulët edukimi dhe kulture (veçojmë grupe të mëdha personash nga komuniteti rom) nuk janë në gjendje të sigurojnë aksesin e nevojshëm në strukturat e NE dhe për rrjedhojë nuk mund të jenë përfitues.

Gjithashtu kufizime jo të drejta janë vënë për familjet që janë transferuar nga zonat rurale në zonat urbane. Edhe kjo kategori shpesh nuk është përfituese e sistemit të ndihmes ndonëse familja jeton në kushte shumë të vështira ekonomike dhe me të ardhura shumë të kufizuara.

2.Percaktim i qartë i kriterëve në mënyrë që të evidentohen realisht familjet në nevojë.

Rishikim i kriterëve në mënyrë që të identifikohen qartë përfituesit me nevojtarë e me legjitimë për

të kualifikuar, të cilët bëjnë pjesë në kushtet e varfërisë ekstreme. Rregullimi lidhur me këtë çështje duhet të bëhet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe masës së ndihmes ekonomike” (i ndryshuar).

Nga praktika e punës së organizatave që punojnë me këtë target grup apo nga eksperiencat e grumbulluar nga strukturat shtetërore të ndihmes sociale rezulton se, jo rrallë ndodh që persona realisht në nevojë dhe



ne kushte tejet te varfera nuk perfitojne nga sistemi i ndihmes. Me konkretisht, grupe te personave me nivel shume te ulet edukimi dhe kulture (veçojme grupe te medha personash nga komuniteti rom) nuk jane ne gjendje te sigurojne aksesin e nevojshem ne strukturat e NE dhe per rrjedhoje nuk mund te jene perfitues.

Gjithashtu kufizime jo te drejta jane vene per familjet qe jane transferuar nga zonat rurale ne zonat urbane. Edhe kjo kategori shpesh nuk eshte perfituese e

sistemit te ndihmes ndonese familja jeton ne kushte shume te veshtira ekonomike dhe me te ardhura shume te kufizuara.

3. Ndryshimi i dispozites per perjashtimin nga e drejta per NE e familjeve qe kane anetar familje emigrante.

Një kriter i tillë nuk ka bazueshmëri logjike, pasi një shtetas shqiptar mund të jetë emigrant jabshtë shtetit, por kjo uk do të thotë a priori se ai aty krijon të ardhura dhe për pasojë është në gjendje të ndihmojë pjesëtarët e familjes në nevojë në Shqipëri. Psh mund të jesh emigrant dhe të mos kesh të ardhura apo të vuash një dënim me burgim në vendi që emigron.

Per kete ceshtje duhet ndryshuar neni 9/1 i ligjit nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", si dhe vendimi i Keshillit te Ministrave nr.787, date 14.12.2005 "Per peraktimin e kriterëve, procedurave dhe mases se ndihmes ekonomike" (i ndryshuar).



4. Eleminim i riskut ne drejtim te subjektivizmit dhe manipulimit ne vendimarrje per caktimin e NE.

Mundesia e parashikimit ne ligj te nje varesie te dyfishte te administratoreve shoqerore nga njesia e qeverisjes vendore dhe Ministri i Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta. Vendosja e filtrave te tjere ligjore per personat e perfshire ne vendimarrjen e caktimit te NE dhe pageses se saj.

Per kete kerkohen ndryshime ne ligjin nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore" dhe ndryshime ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr.787, date 14.12.2005 "Per per caktimin e kriterave, procedurave dhe mases se ndihmes ekonomike" (i ndryshuar), si dhe ne Vendimin nr.512 date 27.07.2006 "Per procedurat e kryerjes se kontrollit te NE, PAK dhe sherbimeve shoqerore"(i ndyshuar).

Se pari; Mungon transparenca ne vendimarrje dhe kjo krijon hapesira per shperndarje jo te drejte te fondeve perkatese te NE.

Përvoja ka treguar se, në kushtet e kufizimeve të fondeve të NE shpesh, përfituesit e padrejtë dëmtojnë interesat e ligjshme të atyre që duhet të jenë përfitues sipas frymës së ligjit.

Kategoria e personave të refuzuar padrejtësisht mund të shërbejë si një mbështetje shumë e madhe e interesit publik për të penguar vendimarrësit për të trajtuar persona që nuk plotësojnë kriteret e ligjit apo për të penguar përfituesit e paligjshëm për të përfituar padrejtësisht.

Në këtë kontekst rritja e trans-





parencës do të mundësonte informimin më të gjërë për përfituesit dhe do të krijonte mundësinë për informim më të mirë të organeve vendimarrëse dhe për rrjedhojë edhe përdorimin më efektiv të fondeve të NE. Se dyti, mungojne procedura efektive për të krijuar hapesira ankimi efektiv ndaj vendimarrjes së përcaktimit të përfituesve konkrete të NE.

Praktika aktuale, e bazuar në mungesën e një procedure të hollësishme të parashikuar për vendimarrjen u mohon aplikuesve të NE mundësinë që të

shprehin opinionin e tyre para organit vendimarrës kolegjal pasi administratori i nuk përcjell në këtë organ rastet për të cilat ai ka opinionin se kërkesa për NE duhet të refuzohet. Për rrjedhojë, aplikantit të refuzuar i mohohet mundësia për një "ankim efektiv" në rastet e refuzimit të kërkesës për NE.

Në këto rrethana duhen riparë procedurat të cilat duhet të japin mundësinë efektive për të realizuar një ankim efektiv qoftë administrativ (duke e lënë Këshillin e Komunës/ Bashkisë si organ kontrolli administrativ) si dhe duke krijuar mundësi reale për një ankim gjyqësor të shpejtë.

5. Informatizimi dhe kompjuterizimi i procesit të zbatimit Programit të NE.

Hartimi i një programi perpunimi të dhenash dhe caktimi përfitimi të NE, ndihmon në shmangien e abuzimeve dhe veprimeve korruptive. Nëse do të kete një shkëmbim on-line informacioni ndërmjet vete strukturave të

ndihmes ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në njesitë e qeverisjes vendore, si dhe ndërmjet këtyre të fundit dhe zyrave të tjera të administratës shoqërore, do të kishte një përpunim më të shpjeguar të dokumentacionit, por edhe një saktësi më të madhe në informacionin që kërkohej. Nëse do të vendoset një sistem i informatizuar, duhet që të rishikohen procedurat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike” (i ndryshuar).

6. Vendosja me një rregullim ligjor ose nenligjor i korrelacionit të drejtë midis uljes së numrit të familjeve përfituese në skemë dhe rritjes së masës së përfitimit të NE.

Një përcaktim i tillë ligjor ose nenligjor, do të sjellë në uljen e fektivitetit, në drejtim të përfshirjes në skemën e NE të familjeve që nuk plotësojnë kriteret. Për këtë qëllim mund të behen ndryshime në ligjin nr.9355, datë

10.03.2005 “Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore”, në nenin 35 ku jepen rregullat për financimin e ndihmës ekonomike.

Një variant tjetër është nxjerrja e aktit nenligjor të parashikuar në nenin 35 paragrafi i dytë, i cili është kundërshtuar nga Ministria e Financave me argumentin që metodologjia e llogaritjes së bllokndihmës është përcaktuar në udhëzimet vjetore që nxjerr MF në zbatim të ligjit të buxhetit të shtetit. Në këtë rast duhet të merret si kriter përcaktimi i varferisë, regjistrimi i popullsisë nga INSTAT.



7. Percaktimi i nje rregulli ne ligj qe fondet e bllok-ndihmes te paperdorura si rezultat i miremenaxhimit ne vendimarrje nga njesia e qeverisjes vendore, te mos sherbejne si nje kriter referimi ne uljen e mases se bllok-ndihmes per kete njesi qeverisje vendore ne vitin e ardhshem buxhetor.

Nje rregullim i tille ligjor, gjithash-tu do te ndikoje ne menaxhimin e drejte te procesit te vendimarrjes se njesise se qeverisjes ven-

dore per caktimin e familjeve qe do te perfitojne NE.

Per kete qellim duhet te behen ndryshime ne ligjin nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", por edhe ne ligjin per menaxhimin e buxhetit te shtetit.

8. Kufizimi i perfitimit te NE ne kohe.

Me qellim qe skema e ndihmes ekonomike te kaloje nga nje skeme sociale pasive ne nje



skeme aktive, ne drejtim te perfitimeve qe ajo ofron, mendoj se duhet te kete nje kushtezim te saj jo vetem me pune dhe sherbime ne komunitet, por edhe kushtezim te saj ne kohe.

Per kete kerkohen ndryshime ne ligjin nr.9355, date 10.03.2005 “Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore” dhe ndryshime ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr.787, date 14.12.2005 “Per percaktimin e kriterëve, procedurave dhe mases se ndihmes ekonomike” (i ndryshuar).

9. Rishikim ne vazhdimesi i koeficienteve per perlogaritjen e te ardhurave dhe gjendjes ekonomike e financiare te familjeve fshatare, si dhe nje vleresim i diferencuar i te ardhurave qe sigurohen ne zonat te ndryshme, sidomos te komunave te veriut dhe verilindjes se vendit.

Te ardhurat qe sigurojne familjet ne fshat ndryshojne nga nje periudhe ne tjetren. Kjo ndikon ne percaktimin e koeficienteve me qellim perfitimin e NE nga familjet fshatare. Duhet te kete

nje rishikim te vazhdueshem te vendimit te Keshillit te Ministrave nr.787, date 14.12.2005 “Per percaktimin e kriterëve, procedurave dhe mases se ndihmes ekonomike” (i ndryshuar), bazuar ne te dhenat qe ka per keto ceshtje INSTAT dhe Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.

10. Në bazë të “Strategjisë për përmirësimin e kushteve të komunitetit Rom” miratuar me VKM nr. 633, datë 18. 09. 2003,



kushtet e varfra të jetesës dhe situata e pafavorizuar sociale e banoreve romë, që jetojnë në Shqipëri janë probleme që po u kushtohet vëmendje nga strukturat qeveritare, si dhe opinioni publik. Treguesit sociale për popullsinë romë janë konsideruar me të ulëta se mesatarja kombëtare, dhe një pjesë e madhe e minoritetit romë jeton në kushte të pasigurta, të pambrojtur dhe në nivelin mesatar të jetesës. Minoriteti romë është i shpërndarë pothuajse në të gjitha zonat, kjo e lidhur ngushtë dhe me elemente të kulturës së tyre. Një pjesë e konsiderueshme

e kësaj pakice përballen me vështirësi të mëdha për të përket strehimit, arsimimit, punësimit, pra nuk ka një gjendje të qëndrueshme ekonomike e sociale. Kjo ndryshueshmëri ndikon në gjetjen e zgjidhjeve afatgjata dhe anasjelltas. Karakteristikat e jetesës dhe familjes romë kanë një ndikim të konsiderueshëm tek fëmijët, të cilët duke mos marrë arsimin e duhur, nuk i përshtaten kërkesave të tregut të punës dhe mundësitë janë shumë më të kufizuara se pjesa tjetër e popullsisë dhe si rezultat sjellin qarkullimin e varfërisë dhe të problemeve sociale në një cikël të mbyllur, i trashëguar neper breza. Gjithashtu mungesa e informacionit rreth edukimit seksual dhe programeve të planifikimit familjar bëjnë që familjet romë të jenë të zgjeruara dhe me shumë fëmijë. Familje të tilla e kanë të vështirë funksionimin e tyre të plotë në kushtet e ekonomisë së tregut, mundësi të paketa të punësimit dhe paaftësi për të gjetur zgjidhje afatmesme dhe afatgjata për të përmbushur nevojat. Duke



qene se shume familje rome nuk përfitojnë ndihme ekonomike për arsye se nuk njohin te drejtat qe janë te garantuara ne ligj, është programuar (i) organizimi i një fushate sensibilizuese ne fushën e mbrojtjes sociale për te drejtat e përfitimit për ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë, pagese barre-lindje dhe te drejta te tjera qe lindin nga legjislacioni ne fuqi; si dhe (ii) nxjerrjen e një akti administrativ, qe obligon komunat dhe bashkite për t’u dhënë asistence ligjore familjeve rome për plotësimin e dosjeve.

Për këtë arsye theksojmë se në legjislacionin e ri për ndihmën ekonomike duhet të parashikohet ndjekja e praktikave “për diskriminimi pozitiv” të pjesëtarëve të komunitetit Rom në përfitimin e ndihmës ekonomike. Në rastet e familjeve të komunitetit Rom, të regjistruara në regjistrat e gjendjes civile (pra të identifikuar), të cilët plotësojnë kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike, të ndiqet një praktikë e diferencuar, në mënyrë që këto familje të përfshihen në skemat

e ndihmës ekonomike. Kjo do të thotë që këto familje ta përfitojnë ndihmën ekonomike, duke **i përjashtuar nga plotësimi i disa kriterëve specifike që kërkohen për përfshirjen në këtë skemë, si për shembull paraqitja e dokumenteve të pronësisë, paraqitja e dokumenteve për regjistrimin në shkollë të fëmijëve, pagesat e energjisë, apo të taksave të tjera, etj.**

Madje sugjerojmë, që këto përjashtime të parashikohen për të gjitha kategoritë e individëve dhe familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.



11. Shmangiet nga abuzivizmi i përshirjes në skemë, duke rregulluar statusin e administratorëve shoqërorë, të cilët kryejnë detyrat e tyre pranë organeve të qeverisjes vendore (Bashki, Komuna). Skema e aplikuar deri më sot, megjithë përmirësimet e ndjeshme nuk po funksionon si duhet. Mendojmë se administratori shoqëror duhet të emërohet nga organet e pushtetit qendror (Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta), duke përcaktuar paraprakisht kushtet në të cilat duhet të punësohen administratorët, pothuajse të njëjta me ato të nënpunësit civil. Shkarkimi i administratorit shoqëror të bëhet po nga Ministri i Punës, për shkaqe të parashikuara në VKM ku kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të paraqesë mendim në rast të propozimit për shkarkim nga Ministri i Punës.

Gjithashtu, ndihma ekonomike të propozohet nga



administratori dhe të miratohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, po ashtu edhe heqja e saj. Keshilli bashkiak ose komunal të ketë rol monitorues dhe kontrollues politikash.

12. Parashikimi në legjislacionin i një programi për Bono Ushqimi (Food Stamps)

Ky program duhet konsideruar si një nga me të rëndësishmit për t'i ofruar kategorive me të varfëra një strukturë ushqimore me të përshtatshme se ajo që ata mund të sigurojnë për familjet e tyre, Praktika ka treguar edhe sot në vendet e zhvilluara dhe të pasura se Programi i Food Stamps i përgjigjet me shpejtësi dhe efektivitet familjeve të varfëra. (P.sh. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sot përfitojnë 35 milion individë të varfër).

Në këtë program duhet të parashikohen nënprograme të veçanta për grupe të veçanta përfituese. Si shembull po përmendim programe speciale afat-shkurtër për ushqim suple-

mentar për gratë, të porsalin-
durit dhe fëmijët ku të përfshi-
hen ushqimet, informacionet
për ushqyerje të shëndetshme,
për kujdesin shëndetësor deri
dhe ofrim i ushqimit falas ose
me ulje çmimi në shkollat fillore
e 9 vjecare. (Ne Shtetet e Bash-
kuara të Amerikës sot ju ofrohet
ushqim suplementar 8 milion
grave shtatzëna dhe pas lindjes,
u ofrohet darkë falas 22 milion
fëmijëve me të ardhura të pak-
ta).

Food Stamps mund të quhet
ne thelb: “Programi i Asistimit
të Ushqyerjes Suplementare”
për të cilin sigurisht kanë nevojë
vetëm shtresat e shoqërisë me
të ardhura te pakta.

Aktet nenligjore do te parashi-
kojnë kriteret e aplikimeve per
kete program, i cili do te jete i
njëjtë në të gjithë vendin. Krye-
sisht do të jetë i bazuar në të
ardhurat mujore të familjes për
person, në pamundësinë për
të vetëgjeneruar të ardhura
shtesë, etj.

Dihet që një familje duhet te
shpenzojë për ushqim, për nevo-
ja ditore si lëvizja me transport,



per elektricitet, uje, taksat lokale, veshje, libra, etj.
Food Stamps mund të organizohet me një sistem të
tillë që të paraqitet një dokument i caktuar që au-
torizon tërheqjen e ushqimeve të rekomanduara në
disa pika të caktuara.

Food stamps eshte i rëndësishem edhe për të arritur
disa objektiva të tjera si:

- Ofrimin e ushqimeve të përshtatshme në familjet me të ardhura të pakta ose patë ardhura;
- Zbutjen e shkallës së ekstremitetit të varfërisë.
- Mbeshtetjen dhe inkurajimin e punësimit sepse ky program përfitohet edhe nga të punësuarit qe jane nen nivelin e varferise.
- Mbrojtjen e familjeve dhe vetë eko



nomisë nga rreziqet që u kanosen sepse, mbron familjen për të kaluar krizën imediate kur janë me fëmijë të vegjël, pa mundësi për të kontribuar, ose kanë të ardhura shumë të pakta, deri sa situata të përmirësohet.

- Mbron ekonominë sepse në kohën kur varferia është e evidente, ulja e fuqisë blerëse ndikon në uljen e shitjeve e si rrjedhim çënohet procesi zinxhir i prodhimit dhe shpërndarjes, rritet perqindja e stokut dhe shkalla e amortizimit e skadencës, por kërkesa për produkte ushqimore e organizuar nga shteti dhe e mbuluar nga fonde

të veçanta e rregullon këtë ekuilibër ekonomik.

13. Ndhimja ekonomike të jepet e diferencuar duke vendosur në ligj tavanin dhe dyshtimin e saj. P.sh ndihma ekonomike e një te varfëri në Bashkinë Sarandë nuk duhet të jetë e njëjtë me atë të Bashkisë Krumë, apo vend malor.

14. Në shumë raste certifikata e pronësive gjithashtu ka qenë problem, sepse ose pronat nuk janë rregjistruar, ose vonohej përgjigja, ose sipas procesit të verifikimeve dhe mbivendosjeve nuk leshohej. Ky është problem që duhet trajtuar gjatë procesit të vlerësimit të dhënies së ndihmës ekonomike dhe ndoshta duhet përfshirë si kriter.

15. Duhet përmirësuar skema e punës në komunitet, për personat që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Pagesa e aftesise se kufizuar

1. Percaktimi ne ligj i vleresimit te aftesise se kufizuar, mbi kriteret te kombinuara mjeksore dhe sociale.

Aktualisht politikat dhe iniciativat ligjore për personat me aftësi të kufizuara, synojnë të zhvendosen nga modeli mjekësor drejt atij social, duke vënë theksin tek të drejtat e tyre, aftësitë e tyre dhe gjetjen e mekanizmave nga ana e shtetit dhe shoqërisë për krijimin e kushteve që të mos ndihen të mënjanuar dhe diskriminuar.

Ne kete kendveshtrim duhen perpunuar ne rradhe te pare kriteret mjekësore te tjera te cilat te mos jene te mbeshtetura ne aftesine e individit per te kryer nje pune, por duhet te vendosen edhe kriteret te tjera ne kendveshtrimin e mundesise se realizimit te nje funksioni te caktuar jetik dhe shoqëror.

Per kete qellim kerkohen ndryshime ne ligjin nr.9355, date 10.03.2005 “Per ndihmen dhe sherbimet shoqërore”

2. Percaktimi ne ligj i autoritetit i cili do te beje vleresimin e aftesise se kufizuar mbeshtetur ne kriteret mjeksore-sociale.

Autoriteti shtetëror i cili ben vleresimin dhe deklarimin e nje individi si person me aftësi të kufizuar eshte Komisioni Mjekësor i Caktimit te Aftesise per Pune i cili eshte organ i ISSH. Me qellim qe te kete nje vleresim mjekësor dhe social te PAK, ndoshta duhet te parashikohet nje komision vleresimi i vecante me strukture rajonale dhe qendrore prane Sherbimit Social



Shteteror.

Per kete qellim kerkohen ndryshime ne ligjin nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", si dhe plotesime lidhur me kriteret dhe procedurat, me akte nenligjore te Keshillit te Ministrave dhe Ministrit te Shendetesise dhe Ministrit te Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta.

3. Percaktimi i nje mase perfitimi pagese aftesie te kufizuar te diferencuar ne varesi te aftesise se kufizuar te personit.

Klasifikimi ne grupe paaftesie te ndryshme, i personave PAK duhet domosdoshmerisht te shprehet edhe ne mase perfitimi pagese te diferencuar.

Per kete qellim duhet te krijohen hapesirat ne ligjin nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", si dhe te ndryshohet Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.618, date 7.09.2006 "Per percaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe mases se perfitimit te pageses per personat me aftesi te kufizuar" (i ndryshuar).

4. Parashikimi ne ligj i mundesise qe nje PAK te kete te drejten te perfitoje pagesen e aftesise se kufizuar dhe te ardhurat nga puna (ne rastet kur personat PAK punesohen).

Nje mundesi e tille duhet te percaktohet ne korelacion te drejte me vleresimin e shkalles se aftesise se kufizuar.

Per kete qellim duhet te krijohen hapesirat ne ligjin nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", si dhe te



ndryshohet Vendimi i Keshillit të Ministrave nr.618, datë 7.09.2006 “Per percaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe mases se perfitimit te pageses per personat me aftesi te kufizuar” (i ndryshuar).

Sherbimet shoqerore

1. Percaktimi ne ligj i mundësisë se ngritjes se sherbimeve shoqerore ne nivel kombetar.

Keto sherbime do te plotësojnë nevojat në nivel kombëtar, për disa grupe specifike si: viktimat e dhunes ne marrëdhëniet familjare, viktimat e trafikimit etj. Gjithashtu ekzistenca e sherbimeve rezidenciale ne nivel kombetar do te ndihmonte per nje zgjidhje te perkohshme te rasteve emergjente te femijeve, te moshuarve dhe personave me aftesi te kufizuara, deri ne sistemimin e tyre ne nje institucion rezidencial te qeverisjes vendore. Per kete ceshtje duhet te ndryshohet ligji nr.9355, date 10.03.2005 “Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore”.

2. Rregullimi nenligjor i kriterëve dhe procedurave per sherbimin e kujdestarise ne familje

Ligji ne teresine e dispozitave te tij nuk ka dhene asnje rregullim lidhur me sherbimin e kujdestarise ne familje, si dhe nuk e ka deleguar kete ceshtje ne nje akt tjeter nenligjor (si Vendim i Keshillit te Ministrave).

Per kete, ligji duhet te percaktojë rregullimin e ketyre ceshtjeve me nje Vendim te Keshillit te Ministrave..



3. Krijimi i Fondit Shoqëror

Nxjerrja e nje Vendimi te Keshillit te Ministrave ne zbatim te nenit 39 te ligjit, për krijimin dhe perdorimin e Fondit Shoqëror, i cili do te mbështese shërbimet e reja të përkujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale.

Grupi i Ekspertëve
TLAS



Mosmarrëveshjet e punës për funksionarët publikë

Në Shqipëri nuk ka një ligj të vetëm që të rregullojë marrëdhëniet e punës në administratën publike që nënkupton ato marrëdhënie ku punëmarës është një organ shtetëror. Legjislacioni bazë që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë është Kodi i Punës dhe ligje të veçanta.

Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës”.

Për rrjedhojë marrëdhëniet e punës së funksionarëve publikë rregullohen, nga Kodi i Punës me përjashtim të rasteve kur ka një rregullim ligjor specifik.

Ndryshimet e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet e tyre të punës përcaktojnë edhe diferencën e garancive që ndikon drejtpërsedrejti në qëndruesh-

mërinë e administratës publike duke e bërë atë të ndjeshme dhe të ndikueshme ndaj ndryshimeve politike në ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Për një analizë më të mirë të kësaj situate po i klasifikojmë në dy grupe mosmarrëveshjet e marrëdhënieve të punës në administratën publike.

Në grupin e funksionarëve publik që gëzojnë rregullim specifik të marrëdhënieve të tyre të punësimit është grupi i funksionarëve publikë të cilët janë subjekt të ligji Nr. 8549 “Statusi i Nepunësit Civil”. Kuptohet që ky grupim gëzon një mbrojtje më të plotë ku përfshihen të gjithë komponentët që ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe profesionalizmin e administratës. Ligji Nr. 8549 “Statusi i nepunësit civil” parashikon rekrutimin, zhvillimin e karrierës, të drejtat dhe detyrat si dhe mënyrën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Për gjykimin e mosmarrëveshjeve për nepunësit civil,





është krijuar Komisioni i Shërbimit Civil, i cili me funksion dhe kompetenca “quasi gjyqësore” luan një rol shumë të rëndësishëm në garantimin dhe respektimin e të drejtave të nëpunësve të administratës publike.

Ky organ administrativ me tiparet e një trupe gati-gjyqësore, duhet të karakterizohet nga pavarësia, paanshmëria, transparencia dhe ndershmëria në zgjidhjen e konflikteve, si dhe përgjegjësia dhe korrektësia në zbatimin e legjislacionit në fuqi. Për të qënë i tillë, është e domosdoshme zhvillimi i një proce-

si të rregullt ligjor, respektimi i një minimumi rregullash procedurale dhe ruajtja e disa standarteve në shqyrtimin e çështjeve. Këto standarte lidhen me thirrjen (njoftimin) e palëve, dëgjimin e pretendimeve të tyre, lejjimin e provave, marrjen e një vendimi përfundimtar dhe arsyetimin e tij, si dhe komunikimin e këtij vendimi palëve. Sa më sipër janë të parashikuara në kreun III të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shërbimit Civil” të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.47, datë 20.06.2002.

Komisioni i Shërbimit Civil gjykon duke iu dhënë zgjidhje të gjithë ankesave ndaj vendimeve lidhur me pranimin në shërbim civil, periudhën e provës, ngritjen në detyrë, levizjen paralele, vlerësimin, masat disiplinore dhe të drejtat e nëpunësit civil. Ai gjykon si një shkallë e parë e një gjykimi administrativ dhe se vendimi i dhënë prej tij është parë i ngjashëm me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Ai duhet t'i zgjidhë

ankesat e mësipërme brenda 30 ditëve nga regjistrimi i tyre¹. Kundër vendimeve të tij, institucionet, mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit, e cila duhet të zbatojë rregullat që parashikon kreu II, në nenin 452 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, për paraqitjen e ankimit dhe gjykimin në apel. Në këtë rast Gjykata e Apelit duhet të shqyrtojë ankimin ndaj një vendimi të dhënë nga Komisioni i Shërbimit Civil sipas nenit 461 të Kodit të Procedurës Civile, që do të thotë njësoj sikurse do të shqyrtonte një vendim të dhënë nga gjykata e shkallës parë. Vendimi i Gjykatës së Apelit është një vendim i formës së prerë, dhe duhet të ekzekutohet nga organet shtetërore.

Në grupin e dytë të mosmarrëveshjeve do të përfshihen ato që rregullohen nga Kodi i Punës. Gjykimi i këtyre mosmarrëveshjeve, bëhet nga Gjykata përmes depozitimit të padisë. Në këto padi marrëdhë-



nia e punës konsiderohet si një marrëdhënie kontraktuale që mbrohet nga Kodi i Punës. Dhe si çdo marrëdhënie kontraktore, duhet të respektojë detyrimet dhe të drejtat e palëve subjekt të kontratës, edhe pse në këtë rast një prej palëve është organ i administratës publike. Thelbi i marrëdhënieve kontraktuale është kontrata e punës. Nëse janë cënuar të drejtat apo detyrimet në këtë kontratë, palet mund t'i drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor të vendbanimit të të paditurit (organit shtetëror) që do të thotë aty ku ndodhet

¹ Neni 8 i ligjit Nr 8549 “Statusi i Nepunesit Civil”

qendra e punës ose në vendin ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij².

Afati brenda të cilëve pala mund t'i drejtohet gjykatës është 180 ditë nga dita e përfundimit të afatit të njoftimit. Kodi i Punës në nenin 155 parashikon se “Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos detyrimin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit me një dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim”. Edhe pse Kodi i Punës parashikon mundësinë e “rikthimit në vëndin e mëparshëm të punës në rastet kur vlerësohet e

2 Neni 7 i Kodit të Punës



paligjshme zgjidhja e marrëdhënieve të punës”, (neni 146 “III”), ky rregull nuk ka gjetur shumë zbatim në praktikën e gjyqësore.

Një tjetër mënyrë procedurale e gjykimit të mosmarrëveshjeve të marrëdhënieve të punës në administratën publike, është përmes gjykimit administrativ. Duke e konsideruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, akt administrativ, pasi ai është shprehje e vullnetit të një organ administrativ. Padia për mbrojtjen e të drejtave të shkeluar, ngrihet në përputhje me nenin 324 të K.Pr.C, i cili parashikon “padia mund të ngrihet kur paditësi argumenton se akti administrativ është i paligjshëm dhe atij i cenohen interesat e të drejtat e tij në mënyrë të drejtperdrejte ose tërthorazi, individualisht ose në mënyrë kolektive”. Pra kërkesë e rëndësishme për legjitimimin e paditësit është argumentimi së atij i “cenohen interesat e të drejtat e tij.” Afati i paraqitjes së padisë është në përputhje me nenin 328 K.Pr.C

“afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga dita e shpalljes ose njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ...”

Edhe pse me mjete të ndryshme procedurale, mbrojtja gjyqësore e funksionarëve publikë nga veprimet (aktet) arbitrare dhe të paligjshme përfaqëson detyrim kushtetues dhe garanci e domosdoshme për të drejtat individuale dhe për mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore në të cilat këta funksionarë ushtrojnë funksionet e tyre.

Me qëllim që të realizohet një gjykim i shpejtë, me synimin për të respektuar detyrimin e një “afatit të arsyeshëm si pjesë shumë e rëndësishme e procesit të rregullt ligjor” është e domosdoshme që gjykimi i mosmarëveshjeve që lidhen me largimin e funksionarëve publikë nga detyra (funksioni) të shqyrtohen nga gjykata të posaçme me procedura që lejojnë gjykim të shpejtë.

Një gjykatë efiçente do të thotë rritje e besimit të publikut së drejtësia do të rivendoset. Pasi nuk

duhet të harrojmë se “drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”, çka do të thotë që sa më shumë të zvarriten ceshjet në gjykatë aq më pak rivendosen të drejtat e shkelura.

Naureda LLAGAMI
Avokate e TLAS



TLAS per rritjen e aksesit ne drejtësi

Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë ka patur dhe ka si objektiv kryesor Rritjen e Aksesit në Drejtësi të grupeve Vulnerabël, duke e ditur që procesi i reformës ligjore dhe institucionale ende nuk po i kushton vëmendjen e duhur aksesit në përgjithësi dhe vecanërisht aksesit të grupeve në nevojë. Shpesh individët në nevojë bëhen objekt i vendimeve të padrejta.

Ekspertët e TLAS draftuan ligjin “ Për Ndihmën Juridike”, i cili u miratua në Dhjetor 2008 dhe hyri në fuqi në Prill 2009. Por zbatimi i ligjit është ende ka mbetur në sirtar gjë që do të thotë se shërbimet ligjore falas me fondet e shtetit nuk mund të sigurohen në të gjithë vendin dhe as për të gjithë target grupet.. Për këtë arsye TLAS vazhdon të aplikojë dhe shkruajë projekte për të siguruar aksesin në drejtësi të in-

dividëve në nevojë. Këtë radhë ishte Komisioni European ai që mundësoi fondet për ofrimin e shërbimeve ligjore falas në Tiranë, Elbasan, Fier, Durrës dhe Lezhë. Grupet e mbuluara nga ky projekt do jenë Komuniteti Rom, minoritetet, individë vulnerabël, të dënuarit vulnerabël që vuajnë dënimet në Institucionet e Vuajtjes së Dënimit, organizatat komunitare përfaqësuese të tyre si dhe punonjësit e zyrave të Ndihmës sociale në qarqet e targetuara.

Objektivi Kryesor :

Të kontribuojmë në zhvillimin e Demokracisë dhe konsolidimin e shtetit ligjor për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Objektiv i vecante:

Forcimi i rolit të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut dhe demokacinë, mbështetja e luftës kundër diskriminimit dhe përjashtimit social përmes përmirësimit të aksesit në drejtësi të grupeve vulnerabël.



Kohëzgjatja <18 muaj>
01. 01. 2010 – 30.06.2011

Objektivat

1. Ofrimi i shërbimeve ligjore falas për grupet vulnerable, përfshirë dhe të dënuarit që vuajnë dënimin në IEVP në qarqet Tiranë, Lezhë, Elbasan, Durrës dhe Fier¹.

2. Ndërgjegjesim i komunitetit vulnerabël në qarqet Tiranë, Elbasan, Fier, Durres dhe Lezhë.

3. Rritja e përfshirjes sociale së familjeve dhe individëve vulnerabël përmes përmirësimit të Legjislacionit “Për Ndihmën Ekonomike dhe Përkujdesjen Sociale”.

Target grupet:

Komuniteti Rom, të dënuarit vulnerabël që mund të përfitojnë nga Shërbimi i Provës, familje dhe individë të tjerë të varfër,

¹ Në qarqet e zgjedhura përfshihen IEVP në Rogozhinë, Peqin, Fushë Krujë, Jordan Misja, Ali Demi, Vaqarri në Tiranë dhe Lezha



organizatat me bazë komunitare dhe administratorët lokalë të ndihmës ekonomike në qarqet Tiranë, Lezhë, Durrës, Elbasan dhe Fier.

Aktivitetet Kryesore për objektivin e parë:

a. Përfaqësimi në Gjykatë i 260 ceshtjeve nga të cilat:

- 110 raste janë për të dënuarit që përfitojnë nga dënimet alternative
- 70 raste janë për ceshtje të tjera civile

b. Përfaqësimi në administratën shtetërore i 70 ceshtjeve që mund të zgjidhen me rrugë administrative

c. Shërbim “clinics” për 306 ceshtje, përfituesit e të cileve kanë nevojë për keshillime dhe perpilime të dokumentave ligjore
Për objektivin e dytë:

- Organizimi i 18 vizitave dhe takimeve dhe shërbimeve ligjore “mobile” re

- spektivisht: 6 ne Tirana, 3 ne Fier, 3 ne Durres, 3 ne Elbasan and 3 ne Lezha.
- Organizimi i 5 seminareve me Orga nizatat me baze komunitare, përfaqë suese të grupeve të synuara në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Lezhë.
- Organizimi i 5 seminareve me admin istratorët e Ndihmës Ekonomike në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Lezhë.

Për objektivin e tretë:

- Ngritja e grupit të ekspertëve për të draftuar ndryshimet në legjislacionin ekzistues “Mbi ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale”



- 20 tryeza e pune për draftimin e ndryshimeve
- 2 tryeza të rumbullakta për prezantimin e draftit fillestar dhe atë final me grupet e interesit.

Struktura organizative e TLAS që do të zbatojë projektin:

- Drejtori Ekzekutiv
- Drejtues i Projektit;
- Dy avokatë;
- Dy avokatë /Këshilltarë;
- Një këshilltar për prob lemet sociale;
- Një administrator / Finan cier dhe një llogaritar
- Studentë Vullnetarë nga Fakultetet e Drejtësisë në Tiranë
- Ekspertë me kohë të pjesëshme, të jashtëm që do të kontraktohen për aktivitetet :

Kontrata e Grantit me Komisionin European u nënshkrua në datën 14. 12. 2009 dhe ka hyrë në fuqi më 01. 01. 2010.

Partnerët e Shërbimit Ligjor Falas në këtë projekt janë përfituesit

e drejtpërdrejtë nga grupet vulnerabël, Organizatat me Bazë Komunitare dhe Administratorët e Ndhmës Ekonomike në Shkalë vendi.

Për zbatimin e këtij Projekti, Shërbimi Ligjor Falas ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi: me Ministrin e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve dhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, në bazë të të cilave avokatët e TLAS do të kenë akses të :

- Vizitojnë të gjitha IEVP e targetuara
- Takojnë të dënuarit që i plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga dënimet alternative
- Aksesojnë dosjet personale të të dënuarve të përzgjedhur
- Plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për përfaqësimin e cështjes në gjykatë
- Zhvillojnë aktivitete ndërgjegjësimi ligjor



në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, për t'i informuar të dënuarit për të drejtat dhe si mund të përfitojnë nga dënimet alternative dhe shërbimi i provës.

- Përfaqësojnë të dënuarit në gjykatat e juridiksionit përkatës të IEVP 've që janë objekt i këtij projekti.
- Ndërgjegjësojnë të dënuarit për të drejtat që burojnë nga legjislacioni për Ekzekutimin e Vendimeve Penale përmes dënimeve alternative dhe përfitimet nga Shërbimi i Provës.

Perfaqësimi me sukses i këtij projekti do të ketë ndikim në uljen e numrit të individëve të dënuar me vendim penal të formës së prerë që vuajnë dënimet e tyre në IEVP, duke ulur mbipopullimin në këto institucione dhe rritur efektivitetin e parandalimit të krimit sepse personat që do të përfitojnë nga dënimet alternative, do të integrohen më mirë në shoqëri, do t'i nënshtrohen më mirë rehabilitimit njerëzor dhe profesional.

Rajmonda BOZO
Drejtoresh Ekzekutive e TLAS

Aktivitetet e “Street Law” gjatë muajve Janar, Shkurt 2010

Grupi i Punës i TLAS i përbërë nga studentët dhe Avokatët e TLAS kanë vizituar dhe takuar individë vulnerabël në këto komunitete:

No	District	Location	Date	No. of Beneficiaries
1	GJIROKASTER	Komuniteti Rom	08.01.2010	70
2	SARANDE	Komuniteti Rom	09.01.2010	65
3	LUSHNJE	Saver, Lushnje	13.01.2010	87
4	LUSHNJE	Ballagat, Lushnje	14.01.2010	76
5	POGRADEC	Komuniteti Rom	22.01.2010	60
6	KORCE	Komuniteti Rom	23.01.2010	70
1	ELBASAN		01.02.2010	102
2	DURRES		02.02.2010	138
3	KRUJE	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	04.02.2010	60
4	GJIROKASTER	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	09.02.2010	73
5	VLORE	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	08.02.2010	126
6	SARANDE	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	10.02.2010	82
7	KORCE	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	18.02.2010	90
8	POGRADEC	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	17.02.2010	87
9	TIRANE	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	23.02.2010	270
10	SHKODER	Juridiksioni i Gjykatës së Rrethit	24.02.2010	70
10	TOTAL	TOTAL	TOTAL	1546

Avokatët që shoqëruan grupet e punës në secilin nga komunitetet e permendura më lartë kanë qënë avokatët e TLAS: V. Kosta, N. Llagami, E. Lula, A. Shega.

Studentët përfshirë në grupet e punës kanë qënë: E. Metalla, A. Metalla, L.Llagami, D. Brahimllari, B. Taco, N. Koroni, I. Bilbili, V. Mata, A. Matoshi, K.Stefa, F.Bregu, M. Meto, A.Shkarpa, E. Hurdha.

Informacioni dhe edukimi Ligjor në këto komunitete synoi:

- Cilat janë shërbimet që ofron Gjykata, mundësia e aksesimit të tyre dhe problemet që dalin

- Cilat janë të drejtat ligjore të individëve që vuajnë dënimin në Institucionet e Vuajtjes dhe Ekzekutimit për të përfituar nga ndryshimi i ekzekutimit të vendimit me dënime e alternative si dhe nga Shërbimi i Provës.

- Cilat janë të drejtat e familjeve në nevojë për të përfituar nga shërbimet e kujdesit social dhe ndihma ekonomike.

- Ndryshimet e Ligjit “Për Gjendjen Civile” dhe problemet që dalin gjatë procesit të zbatimit të këtyre ndryshimeve nga punonjësit e zyrave të gjendjes Civile.

Gjatë këtyre takimeve dhe mbledhjeve u shpërndanë publikime dhe revista të zyrës, informacione të tjera si dhe u identifikuan shumë raste kur individët nga grupet në nevojë kishin

raste që mund të përfaqësoheshin nga TLAS. Disa prej tyre janë paraqitur pranë TLAS për të kërkuar shërbimet e ofruara nga zyra jonë.

Edhe pse shumë komunitete dhe individë në nevojë kanë përfituar nga shërbimet e TLAS, përsëri aktivitetet e “Street Law” do të vazhdojnë, pasi problemet janë të shumta, ato ndryshojnë nga komuniteti në komunitet, si dhe shfaqen probleme dhe raste të reja që kërkojnë trajtim.

Grupi i studentëve të Programit Internship TLAS



Histori e vërtetë

Viti 2009 pati disa specifika në fushën e përzgjedhjes, trajtimit të rasteve apo të prioriteteve që ato duhet të zënë kur është fjala e nevojës për t'u përfaqësuar në Gjykatë. Si Avokate prej më shumë se 7 vjetësh në TLAS kam parë se këto prioritetet kanë ndryshuar nga viti në vit, ato nuk kanë qënë statike por të larmishme. Ajo që ka qënë dhe mbetur e pandryshueshme është përzgjedhja e bazuar në shkallën e varfërisë së individit apo familjes që duhet përfaqë-

suar. Dhe për hir të së vërtetës, duke qënë se varfëria është përshkallëzuar në drejtimin negativ të boshtit, dhe kapaciteti i zyrës së TLAS është i limituar, është bërë shumë kujdes që të përzgjidhen rastet më ekstreme. Dua të shkruaj në këtë histori të vërtetë një rast i cili përfaqëson një grup të tërë fëmijësh që tashmë nuk kanë nevojë të përfaqësohen në gjykatë për regjistrim në gjëndje civile të lindjes së tyre, por kanë nevojë të përfaqësohen për përcaktimin e “kujdestarit” të tyre. A ka pas qënë nevoja e përfaqësimit të këtij grupi rastesh dhe përse TLAS e konsideroi një nga prioritetet e vitit 2009?

Për shëmbull gjatë viteve 2007, 2008 regjistrimet e lindjeve të fëmijëve në regjistrin themeltar përmes gjykatës okuponin ngarkesën e punës së avokatëve të TLAS. Në vitin 2009, në kushtet kur ndryshimet në ligjin e gjëndjes civile ndikuan në uljen e ndjeshme dhe reduktimin e këtij fenomeni, TLAS filloi t'i kushtojë vëmendje zhvillimeve të



reja të cilat ekzistonin edhe më parë si çështje të nevojshme për t'u përfaqësuar në gjykatë.

Ndër partnerët tanë numërohen në vecanti institucionet rezidenciale të fëmijëve dhe të moshuarve. Në zyrën e TLAS shfaqen përfaqësuesit e Fshatit "SOS", të cilët kërkuan ndihmë ligjore për një grup rastesh të komplikuar të fëmijëve që janë të strehuar pranë kësaj qëndre rezidenciale. Rasti nga rasti ndryshon sepse dhe prejardhja e fëmijëve, apo shkakët për të cilat fëmijët gjenden në këtë institucion janë të shumëllojshme. Unë po shtjelloj vetëm njërin prej tyre:

Pse fëmijët gjenden sot në Fshatin SOS?

Pra në Fshatin SOS u strehuan 3 fëmijët e familjes Z. Ata kishin mbetur jetim dhe pa përkrahje. Të miturit janë me origjinë nga rrethi i Pukës, dhe familja e tyre e përbërë prej 6 anëtarësh jetonte prej dy vitesh në rrethin e Durrësit ku ishin zhvendosur për të siguruar kushte më të mira jetese. Si rezultat i një konflikti me

armë të ndodhur me fqinjët e tyre kanë gjetur vdekjen tre prej gjashtë anëtarëve të familjes së tyre nëna, babai dhe një motër. Tre të miturit e tjerë të familjes Z ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes ditën e tragjedisë. Fëmijët janë të moshave 8, 11 dhe 14 vjeç. Xhaxhai dhe tezja e të miturëve janë personat me të afërt për t'u kujdesur dhe për të marrë përgjegjësitë e prindërve në mungesë. Por kushtet sociale-ekonomike të tyre nuk plotësonin kërkesat minimale të nevojshme për rritjen e tre fëmijëve si dhe për edukimin e tyre. Kjo situatë i detyroi të afërmit të



kërkojnë ndihmë nga TLAS për t'i sistemuar 3 jetimët pranë fshatit "SOS".

Këtu fillon dhe përqasja apo trajtimi "holistic" ndaj këtij tipi cështjeje, që do të thotë si TLAS hap pas hapi fillon zgjidhjen në rrugë ligjore të drejtave të fëmijëve gjithmonë duke parë interesin më të mire e më të lartë të tyre.

Hapat e para të ndërmara nga



Këshilltari i TLAS:

- U rekomanduan fëmijët në Fshatin SOS pasi u verifikua se fëmijët plotësonin kriteret e aplikimit në këtë institucion si atë të moshës, të mungesës së kujdestarisë, kushtet e rënda ekonomike, etj.

- U tërhoqën të dhëna të familjes Z nga zyra e Gjëndjes Civile si certifikata familjare, martesore, të vdekjes, individuale të secilit prej fëmijëve, vërtetime të ndryshme që nuk përfitonin asnjë ndihmë ekonomike apo përkujdesje sociale, etj.

- U ekzaminua shëndeti i fëmijëve përmes një sërë analizash të përcaktuara mjeksore. U tërhoq epikriza e historisë së mjekimit të fëmijëve nga mjeku i familjes për të parë historinë e shëndetit të tyre.

- Fshati "SOS" mori vendimin të pranojë aplikimin dhe vazhdoi të vleresojë më tej kushtet ekonomike sociale të fëmijëve dhe të familjarëve të tyre.

Sot fëmijët jetojnë pranë Fshatit “SOS”, dhe janë përshtatur me mjediset dhe me edukatorët. Por Fshatit “SOS” i mungon një status ligjor kujdestarie, gjë që ligjërisht e pengon atë të realizojë në mënyrë të plotë të drejtat e të tre miturëve në raport me institucionet shtetërore, apo me të tretët. Në këto kushte përfaqësuesit e këtij institucioni u paraqitën në TLAS për të vazhduar bashkëpunimin përmes ndihmës ligjore.

Hapat e tjera të ndërmarra nga avokati i TLAS:

Avokati i TLAS studioi me vëmendje rastin konkret dhe Kodin e Familjes. Kodi parashikon se “vdekja e prindërve të cilët ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijës të tyre të mitur dhe pamundësia e të afërmeve për tu kujdesur përbenë shkak kryesor për tu vlerësuar nga gjykata për vendosjen e të miturëve në kujdestari në një institucion të licencuar për perkujdesje duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë

të fëmijës”

Nisur nga kjo, dhe duke theksuar nenet 263 dhe 271 të Kodit të Familjes:

Nenin 263 të K.familjes në të cilën parashikohet se: “ Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.



Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit”.

Neni 271 i Kodit të Familjes “Kujdestaria mbi të miturin, i cili nuk ka të afërm të njohur ose të afte për të ushtruar detyren e kujdes-

tarit, mund t’i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat i lecusuar për perkuajdsjen e femijeve”

Avokati filloi menjëherë të plotësojë dokumentacionin që e kërkon procedura për të kërkuar kujdestarinë e fëmijëve përmes vendimit të gjykatës si:

- Siguroi Vendimin e Komisionit Qëndror pranë Shërbimit Social Shtetëror
- Siguroi Libreza anëtarësie të “Jetimit” për secilin nga fëmijët .
- Siguroi Deklaratën Noteriale nga të afërmit e femijeve.
- Përpiloi Kërkesë padinë dhe e paraqiti në gjykatë

Fëmijët janë në kushte të favorshme dhe interesi më i lartë i tyre është i përfaqësuar ligjerisht nga Fshati SOS.



Histori e vërtetë

Pranë Shërbimit Ligjor Falas Tiranë janë paraqitur përfaqësuesit e Fshatit “SOS”, të cilët kërkuar ndihmë ligjore për një rast të komplikuar të strehuar pranë kësaj qendre rezidenciale. Në qendrën e tyre janë strehuar 3 fëmijë të cilët kishin mbetur jetim dhe pa përkahje. Të miturit janë me origjinë nga rrethi i Pukës, dhe familja e tyre e përbërë prej 6 anëtarësh jetonte prej dy vitesh në rrethin e Durësit ku ishin zhvendosur për të siguruar kushte më të mira jetese. Si rezultat i një konflikti me armë të ndodhur me fqinjët e tyre kanë gjetur vdekjen tre prej gjashtë anëtarëve të familjes së tyre nëna, babai dhe një motër, ndersa pjesa tjetër e familjes ka qënë të pranishëm në vendin e ngjarjes. Pas kësaj tragjedie për tre fëmijët e ngelur jetim të cilët i përkasin moshës 4.5 vjeç deri në 15 vjeç janë kujdesur të afërmit e familjes. Xhaxhai dhe teza e të miturëve janë përsenat me të afërt që janë kujdesur për ta duke marrë përgjegjësitë

e prindërve në mungesë. Por kushtet sociale-ekonomike të tyre nuk lejonin që tu ofronin këtyre fëmijëve kushte nevojshme për rritje dhe edukim. Duke u nisur nga pamundësia ekonomike dhe vështirësitë e jetës xhaxhai i tyre ka kërkuar ti strehojë të 3 jetimët pranë fshatit “SOS”, me qëllim rritjen dhe edukimin e tyre duke iu ofruar kushte më të mira, si dhe mundësi për të patur një arsimim më të plotë. Më tej institucioni i Fshat “SOS” pasi mori vendimin ti strehojë duke vlerësuar kushtet ekonomike sociale si të fëmijëve ashtu dhe të familjarëve të tyre. Tashmë



fëmijët kanë më shumë se 3 vjet që jetojnë pranë Fshatit "SOS", ku ndjehen të përshtatur me mjediset dhe me edukatorët. Nisur nga kjo situatë duke qënë se Fshatit "SOS" i mungon një status ligjor kujdestarie, e pengon atë që të realizojë në mënyrë të plotë të drejtat e të tre miturëve në raport me institucionet shtetërore, apo me të tretët. Në këto kushte përfaqësuesit e këtij institucionit u paraqitën për të kërkuar ndihmë ligjore.

Avokati i TLAS studio çëshjten

dhe Kodit të Familjes i cili parashikonte se vdekja e prindërve të cilët ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijës të tyre të mitur dhe pamundësia e të afërmeve për tu kujdesur përbën shkak kryesor për tu vlerësuar nga gjykata për vendosjen e të miturëve në kujdestari në një institucion të licencuar për perkujdesje duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, filloi menjëherë procedurat gjyqësore në gjykatë.



Histori e vërtetë

Në Qendrën e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë (TLAS) trokiti një burrë rreth të tridhjetave, që nuk mund të fliste, por lëshonte vetëm tinguj. Ishte edhe shumë i gjymtuar fizikisht, me duart pothuajse të palevizëshme dhe ecte me vështirësi, duke tërhequr këmbët. Të komunikojë me të nuk ishte e thjeshtë, u desh njëfarë kohe, me disa pyetje për të mundur përgjigjet e tij përmes tundjes mohuese apo pohuese të kokës. Nga fytyra nuk i ndahej një buzëqeshje e ëmbël, sytë e tij përgjigjeshin me kënaqësi dhe mirënjohje, sa herë që kuptonim atë cka ai donte të thoshte.

Kishte pashaportën me vete dhe ai ishte E.E. Kishte dhe disa dokumenta zyrtarë, të shkruara në greqisht, të cilat këmbëngulte që ne t'i lexonim dhe të zbulonim përmbajtjen e tyre.

1. Pranimi dhe cfarë u mësua përmes intervistës së aplikantit:

E.E u regjistrua dhe pranua si

klient i TLAS.

Ju kërkua kontakti i një familjari.

Ju premtua që problemi i tij do të zgjidhej nga TLAS.

Si dhe shpenzimet e për vazhdimësinë e çështjes do të mbuloheshin nga TLAS.

Dokumentat në greqisht u përkthyem dhe u noterizuan. Nga ato u mësua se E.E kishte pësuar aksident të rëndë automobilistik në shtetin fqinj, Greqi. Dokumenti ishte një kërkesë nga një klinikë mjeksore e burgut në Greqi, që i drejtohej Institucionit të Policisë dhe Prokurorisë së



asaj zone dhe për dijeni Ministrisë së Drejtësisë, për transportimin urgjent të të burgosurit E.E. për kurim të specializuar. Në dokument përcaktohej edhe diagnoza e sëmundjes dhe lloji i mjekimit të filluar.

Nga intervista doli se E.E kishte kaluar kufirin grek në mënyrë të paligjshme për të gjetur punë. Pas aksidentit dhe mjekimit që i shpëtoi jetën duke e lënë të gjymtuar, ishte përcjellë në Shqipëri nga autoritetet greke. Ishte fare i vetëm, jetonte në Tiranë, flinte rrugëve, mbante me vehte

një qese me pak sende personale. Familja e tij (nëna, babai, motra, vëllezërit dhe vajza) vazhdonin të jetonin prej vitesh në Greqi.

1/a. Shërbimet që u ofruan nga TLAS për klientin E. E.:

- Të dhënat e pashaportës për të ndërmjetësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjëndjes Civile, pranë Ministrisë së Brendshme.
- U kërkua në database-in e Regjistrit Kombëtar të Gjëndjes Civile dhe u gjet se E.E ishte banor në Njësinë Bashkiake Nr.x të Tiranës.
- Filloi proceduara për mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm për t'ju drejtuar Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) për të përfutur statusin e invaliditetit dhe të ndihmës ekonomike.
- U Përgatit një letër e detajuar sqaruese për punonjëset



e zyrës së gjëndjes civile të Njësisë Bashkiake no.x, ku i kërkohej paisja me llojet e certifikatave të nevojshme për procedurën e filuar.

- U Përgatit një letër tjetër e detajuar për mjekun e lagjes, së cilës ju bashkëngjiten dokumentat mjekësore të përkthyer dhe sqarime të tjera për E.E.

- Të dy instancat e mësipërme u treguan bashkëpunuese dhe të të gatëshme për të ndihmuar E.E .

- E.E. u paraqit në KMCAP, duke ndjekur udhëzimet e TLAS, u klasifikua për të përfituar statusin e invalidit dhe si rezultat edhe ndihmën ekonomike mujore prej 8.700 lekë.

Klienti E.E. ishte një bashkëpunues shumë i mirë, inteligjent dhe kuptonte drejt të gjitha kriteret që duhen plotësuar, ishte i përpiktë dhe këmbëngulës për të ndjekur udhëzimet që TLAS i jepte. Prandaj dhe mbyllja me sukses e rastit të parë ishte një arritje e rëndësishme sepse ka

një burim financiar për të mbijetuar.

1/b. Rasti tjetër i E.E. ishte strehimi i tij.

Ai flinte rrugëve, në vende të rastësishme. Si mund të ndihmohej?

E vetmja rrugë ligjore ishte evidentimi përmes regjistrimit zyrtar në listën e të pastrehëve. Regjistrimi në listë ishte i domosdoshëm, në rast të kundërt nuk do njihej si i pastrehë nga



strukturat përkatëse të strehimit edhe pse regjistrimi në këtë listë nuk do të thoshte se përfiton menjëherë banesë.

Hapat që u ndërmorën:

- Filluan procedurat për të qënë kryefamiljar, pra të veçohet nga trangu familjar si familje më vehte.
- Plotësimi i formularit tip i përgatitur nga Bashkia e Tiranës.
- Noterizimi i formularit dhe dorëzimi në zyrën e strehimit të



Njësisë Bashkiake no.x, ku bëhet regjistrimi në database dhe janë të njohur zyrtarisht si të pastrehë nga Bashkia e Tiranës.

- Ndërkohë duke ditur që realizimi i këtij hapi nuk zgjidhte shpejt gjëndjen e vështirë të strehimit të E.E, ai u rekomandua të shoqata e personave me aftësi të kufizuar, ADRIF, e cila mundi t'i sigurojë EE vend fjetje për disa muaj.

1/c. Rasti tjetër i E.E ishte vajza e tij e paregjistruar në gjëndjen civile

Sot vajza e tij jetonte në Greqi me prindërit e tij. Kjo vajzë kishte lindur nga një lidhje jashtë martesë, kur E.E ishte në gjëndje të mirë shëndetësore. Nëna e vajzës ishte larguar nga shtëpia, duke e lënë vajzën në kujdesin e familjes së babait të fëmijës.

E.E kishte një çertifikatë të gjëndjes civile të fëmijës, të lëshuar nga një zyrë greke e gjëndjes civile.

Këshillat e dhëna:

- Me këtë dokument fëmi-

ja nuk mund të regjistrohej.

- Çertifikata duhet të vërtetohej nga Ministria e Brëndshme dhe Ministria e Jashtme e Greqisë dhe me tej duhet të legalizohej nga konsullara shqiptare në Selanik, atje ku kishte lindur fëmija.

- Fëmija mund të regjistrohej vetëm nga nëna e saj, apo nga familja e nënës.

Hapat e ndërmara:

- TLAS kontaktoi me telefon me motrën e E.E. që jeton

në Selanik duke i kërkuar asaj të zbatonte hapat e përmendura më sipër për legalizimin e çertifikatës së fëmijës.

- Pas këtij hapi do gjëndet kontakti me nënën apo familjen e nënës së vajzë për t'u finalizuar regjistrimi i saj në gjëndjen civile.

Rasti vazhdon dhe Shërbimi Ligjor Falas Tiranë është i kënaqur që jeta e E.E. ka filluar të ndryshojë dhe të normalizohet.



Histori e vërtetë

Pranë Zyrës tonë u paraqit një klient i cili jetonte në qytetin e Tiranës me initiale R.D, e cila ishte transferuar në Tiranë nga qyteti i Kukësit. Pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë, ai u paraqit duke kërkuar mbrojtje ligjore për të drejtat që i takonin me ligj asaj por që ajo nuk mund t'i gëzonte pikërisht për shkak të veprimeve neglizhente të punonjësve të administratës së qytetit të saj të lindjes.

Pasi u krye një intervistë me të, u identifikuan problemet e saj. Nga intervista u konstatua se klientja R.D për një periudhë të gjatë kohe kishte jetuar në qytetin e Kukësit ku edhe kishte lindur.

Në momentin që nga prindërit e saj ishte bërë deklarimi i lindjes pranë punonjësit të gjendjes civile të kohës, nga ana e këtij punonjësi është regjistruar gabim seksi i fëmijës, pra i klientes R.D duke e regjistruar atë si të seksit mashkull, ndërkohë që R.D është e seksit femër.

Ky fakt në momentin e regjistrimit të fëmijës në vitet 1979 nuk ka qenë i ditur nga prindërit e saj dhe kjo gjendje ka vazhduar për një kohë të gjatë derisa R.D arriti në moshë madhore.

Në momentin që është paraqitur pranë Zyrave të Gjendjes Civile të Tiranës pasi kishte bërë transferimin nga Kukësi ka vërejtur se në çertifikatën e lindjes figuronte e seksit mashkull. Në këtë kohë klientja është ankuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile por



nuk ka arritur ta zgjidhë problemin e saj.

Në këtë moment klientja R.D e cila kishte marrë vesh pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për shërbimet që ofronte Zyra e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, është paraqitur pranë nesh duke kërkuar konsulencë juridike për zgjidhjen e problemit të saj.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatët e zyrës tonë.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një padi me objekt “Deklarimi i pasaktësisë së rubrikës “seksi” e aktit të lindjes së klientes R.D, duke e korigjuar nga i seksit “mashkull” në seksin “femer””.

Theksoj se nga ky gabim i kryer nga punonjësit të cilët kanë qenë përgjegjës për mbajtjen e aktit të lindjes së klientes R.D asaj i ka ardhur një dëm mjaft i madh moral dhe ekonomik, pasi

klientja e mësipërme nuk mund të pajisej me dokument identifikimi, nuk mund të lidhte martesë ligjore me bashkëshortin e saj dhe nuk mund të regjistronte fëmijët e saj në gjendjen civile.

U mendua që fillimisht të mbledheshin të gjithë materialet e nevojshme për këtë gjyq. Kështu u morën nga qyteti i Kukësit kopje të aktit të lindjes së klientes R.D, çerfitikata familjare e vitit 1974, dokumentat e identifikimit të famijarëve pasi klientja R.D nuk kishte asnjë dokument që të bënte të mundur identifikimin e saj.



Gjithashtu u mor edhe çertifikata e asistencës në lindje e R.D si dhe vërtetime nga ndërlidhësi me komunitetin dhe Drejtoria Arsimore e Qytetit Kukës.

Me të gjitha këto dokumente iu drejtuar një shkresë Zyrës së Gjendjes Civile ku iu kërkua që të korrigjonte gabimin e kryer në regjistrimin fillestar të R.D.

Nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile u refuzua korigjimi i gabimit për të ndryshuar rubrikën e seksit të klientes R.D nga e seksit të gabuar “mashkull” në atë të saktë “femër”.

Në këto kushte duke parë refuzimin e Zyrës së Gjendjes Civile u

vendos që të përpilohej një padi për në gjykatë për ta korigjuar këtë gabim në rrugë gjyqësore.

Neni 32 i K.Pr.Civile shprehet se “padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur”.

Në këto kushte, bazuar në nenin 43/3 të ligjit nr. 8950 i cili shprehet se “Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cënuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t’i parashtrojnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile.”. Për shkak se klientja ishte personi i interesuar, për të kërkuar deklarin e pasaktësisë dhe ndreqjen e gabimit përse i përket rubrikës së seksit, i shënuar gabim “mashkull” në seksin e saktë “femër”.

U depozitua kërkesë padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvillu-





an disa seanca gjyqësore, gjatë kësaj kohe vazhdimisht çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen. Gjykata arriti në përfundimin se klientja R.D kishte të drejtë në kërkimin e saj duke i njohur në këtë mënyrë të drejtën e korrigjimit të rubrikës së seksit, i shënuar gabim “mashkull” në seksin e saktë “femër” .

Mbas një pune të gjatë duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Zyrës për Shërbimin Ligjor Falas u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klienti R.D.

Adrian Shega
Avokat i TLAS

SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË

Nr. 1 / 2010

TLAS

